

# **Agro & Social Fund Shpk**

## **Pasqyrat Financiare**

**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

**(me raportin e audituesve të pavarur bashkëngjitur)**

## Përmbajtja

---

<b>RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR .....</b>	<b>.....</b>
<b>PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR .....</b>	<b>1</b>
<b>PASQYRA E FITIMI HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE .....</b>	<b>2</b>
<b>PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE.....</b>	<b>3</b>
<b>PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL .....</b>	<b>4</b>
<b>1. ENTITETI RAPORTUES.....</b>	<b>5</b>
<b>2. BAZAT E PËRGATITJES .....</b>	<b>5</b>
<b>3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL.....</b>	<b>6</b>
<b>4. NDRYSHIME NE POLITIKAT KONTABEL DHE SHENIMET SHOQERUESE .....</b>	<b>18</b>
<b>5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR .....</b>	<b>19</b>
<b>6. INFORMACION SHITESE MBI PASQYREN E FLUKSIT TE PARASE .....</b>	<b>26</b>
<b>7. MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTET ME TO.....</b>	<b>26</b>
<b>8. HUA DHE PARADHENIE PËR KLIENTËT.....</b>	<b>27</b>
<b>9. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE.....</b>	<b>29</b>
<b>10. TE DREJTAT E PERDORIMIT TE ASETVE DHE DETYRIMI I QIRAVE .....</b>	<b>29</b>
<b>11. AKTIVE TË TJERA .....</b>	<b>30</b>
<b>12. HUATË.....</b>	<b>30</b>
<b>13. DETYRIME TË TJERA .....</b>	<b>30</b>
<b>14. KAPITALI I PAGUAR.....</b>	<b>31</b>
<b>15. TË ARDHURA NETO NGA INTERESAT .....</b>	<b>31</b>
<b>16. TË ARDHURA TË TJERA.....</b>	<b>31</b>
<b>17. SHPENZIME PERSONELI .....</b>	<b>31</b>
<b>18. SHPENZIME TË TJERA .....</b>	<b>31</b>
<b>19. TATIMI MBI FITIMIN .....</b>	<b>32</b>
<b>20. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA.....</b>	<b>32</b>
<b>21. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA .....</b>	<b>33</b>
<b>22. NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT .....</b>	<b>33</b>



Ernst & Young Certified Auditors  
Albania Branch  
NUIS: K619110121  
Ibrahim Rugova Str, Sky Tower, 6<sup>th</sup> floor  
1001, Tirana, Albania

Tel: +35542419575  
ey.com

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarin e Agro & Social Fund sh.p.k.

Raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare

### Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Agro & Social Fund sh.p.k. (më poshtë "Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2021, pasqyrën e fitim ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2021, dhe performancën financiare dhe flukseve të parasë për vitin e mbyllur më atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF-të").

### Baza për opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin *Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) ("Kodi i BSNEPK") dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë ("Kodi IEKA"), së bashku me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", të ndryshuar, që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK dhe Kodin IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Informacione të Tjera të Përfshira në Raportin Vjetor 2021 të Agro & Social Fund sh.p.k.

Informacione të tjera përfshijnë informacione në Raportin Vjetor të Shoqërisë për vitin 2021, përgatitur në përputhje me nenet 17 dhe 19 të Ligjit Nr. 25\2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti Vjetor i Shoqërisë për vitin 2021 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit.

Opinionit ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lartë kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomalitë materiale.

## Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

## Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- ▶ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinion mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- ▶ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- ▶ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në të një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Agro & Social Fund sh.p.k, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar  
Dega në Shqipëri

Ernst & Young  
24 qershor 2022  
Tiranë, Shqipëri



Mario Vangjel  
Auditues Ligjor

# Agro & Social Fund shpk

---

## Pasqyra e pozicionit financiar

Shumat në mijë Lek

	Shënimi	2021	2020
<b>Aktivët</b>			
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to	7	120,380	51,205
Hua dhe paradhënie për klientët	8	830,119	736,117
Aktivët afatgjata materiale	9	14,035	15,014
Të drejtat e përdorimit të aktiveve	10.1	45,714	45,768
Aktive të tjera	11	3,698	10,710
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>1,013,946</b>	<b>858,814</b>
<b>Detyrimet dhe Kapitali</b>			
<b>Detyrimet</b>			
Huatë	12	622,126	515,141
Detyrimi mbi qiratë	10.2	46,533	46,661
Detyrime të tjera	13	24,245	16,126
		<b>692,904</b>	<b>577,928</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali i paguar	14	289,375	289,375
Humbje të mbartura		(8,489)	(29,147)
Fitimi i vitit		40,156	20,658
		<b>321,042</b>	<b>280,886</b>
<b>Totali i Detyrimeve dhe Kapitali</b>		<b>1,013,946</b>	<b>858,814</b>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 5 deri në 33, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

# Agro & Social Fund shpk

---

## Pasqyra e Fitimi Humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

Shumat në mijë Lek

	Shënimi	2021	2020
<b>Interesa</b>			
Të ardhura nga interesi	15	221,519	184,982
Shpenzime për interesa	15	(36,084)	(30,015)
<b>Të ardhura neto nga interesat</b>		<b>185,435</b>	<b>154,967</b>
Të ardhura të tjera	16	1,652	1,481
<b>Shpenzime Operative</b>			
Amortizim i aktiveve	9, 10.1	(17,483)	(17,204)
Shpenzime personeli	17	(85,177)	(77,104)
Humbje nga zhvlerësimi i huave	8	(23,140)	(20,050)
Shpenzime të tjera	18	(17,300)	(17,000)
Fitimi/ (Humbje) neto nga kurset e këmbimit		4,929	(66)
<b>Totali i shpenzimeve operative</b>		<b>(138,171)</b>	<b>(131,424)</b>
<b>Fitimi përpara tatimit</b>		<b>48,916</b>	<b>25,024</b>
Tatimi mbi fitimi	19	(8,760)	(4,366)
<b>Fitimi i vitit</b>		<b>40,156</b>	<b>20,658</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatimit		-	-
<b>Total i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>40,156</b>	<b>20,658</b>

Pasqyra e fitimi humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet lexuar së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 5 deri në 33, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

# Agro & Social Fund shpk

## Pasqyra e Flukseve Monetare

Shumat në mijë Lek

	Shënime	2021	2020
<b>Flukset monetare nga aktivitete operacionale</b>			
Fitimi i vitit përpara tatimit		48,916	25,024
<i>Korrigjime për:</i>			
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	9	3,714	4,174
Amortizimi i te drejtave te perdorimit te aktiveve	10.1.1	13,769	13,030
Humbje nga zhvlerësimi i huave	7	23,140	4,174
Të ardhura nga interesi	15	(221,519)	(184,982)
Shpenzime për interesa	15	36,084	30,015
Shpenzime nga kurset e këmbimit		553	
<i>Ndryshime në:</i>			
Hua dhe paradhënie për klientët		(119,663)	(124,015)
Aktive të tjera		3,273	1,041
Detyrime të tjera		8,119	(1,064)
		<b>(203,614)</b>	<b>(216,727)</b>
Interesi i arkëtuar		224,040	176,355
Interesi i paguar		(39,103)	(36,950)
Tatimi mbi të ardhurat i paguar	19	(5,022)	(4,967)
<b>Flukset monetare të përdorura në aktivitete operacionale</b>		<b>(23,699)</b>	<b>(82,289)</b>
<b>Flukset monetare nga aktivitete investuese</b>			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	9	(2,735)	(1,374)
<b>Flukset monetare perdorur në aktivitete investuese</b>		<b>(2,735)</b>	<b>(1,374)</b>
<b>Flukse monetare nga aktivitete financiare</b>			
Fonde të paguara/marrë si hua dhe qira financiare	6	110,819	84,533
Ripagesa për detyrimet mbi qiratë	10.2	(15,210)	(12,555)
<b>Flukset monetare nga aktivitetet financuese</b>		<b>95,609</b>	<b>71,978</b>
(Rënia)/ rritja neto e mjeteve monetare dhe ekuivalenteve me to		69,175	(11,685)
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to në fillim te vitit	6	51,205	62,890
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to në fund të vitit</b>	<b>6</b>	<b>120,380</b>	<b>51,205</b>

Pasqyra e flukseve monetare duhet lexuar së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 5 deri në 33 të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

# Agro & Social Fund shpk

## Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

Shumat në mijë Lek

	Kapitali i paguar	Fitim / Humbje te mbartura	Totali
<b>Balanca më 1 Janar 2020</b>	<b>289,375</b>	<b>(29,147)</b>	<b>260,228</b>
Fitimi neto për vitin	-	20,658	20,658
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi	-	-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>20,658</b>	<b>20,658</b>
<b>Balanca më 31 dhjetor 2020</b>	<b>289,375</b>	<b>(8,489)</b>	<b>280,886</b>
Fitimi neto për vitin	-	40,156	40,156
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi	-	-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>40,156</b>	<b>40,156</b>
<b>Balanca më 31 dhjetor 2021</b>	<b>289,375</b>	<b>31,667</b>	<b>321,042</b>

Keto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi më 23 Qershor 2022 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:

Rozana OROZI

Drejtoreshë Ekzekutive



Lindiana ZYFI

Drejtoreshë e Departamentit të Financës

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 5 deri në 33, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



# Agro & Social Fund shpk

## Shënimet për pasqyrat financiare për periudhën deri më 31 dhjetor 2021

---

(Shumat në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

### 1. Entiteti raportues

Agro & Social Fund sh.p.k. (“Shoqëria”), është institucion mikrofinanciar i vendosur në Tiranë. Shoqëria është regjistruar në Shqipëri në vitin 2007. Aktiviteti i mikrofinancës është transferuar tek Shoqëria si rezultat i ndarjes së këtij aktiviteti nga World Vision Albania (‘WVA’).

Bazuar në kontratën e shitblerjes së aksioneve më datë më 1 nëntor 2016 midis Fondi Besa sh.a. (“blerësi”) dhe VisionFund International (“shitësi”), palët kanë dakord që të transferojnë pronësinë e Shoqërisë. Ky proces përfundoi më 28 dhjetor 2016, me përmbushjen e kushteve të përcaktuara në kontratë, në lidhje me aprovimet që kërkohen prej autoriteteve përkatëse, duke përfshirë Bankën e Shqipërisë, si një parakusht për transferimin e pronësisë.

Më 31 dhjetor 2021, Shoqëria operon nëpërmjet Zyrës së saj Qendrore në Tiranë dhe gjashtë degëve (2020: pesë dege) të cilat ndodhen në Tiranë, Lezhë, Korçë, Elbasan, Lushnje dhe Durrës dhe pesë njësi (2020: pesë njësi), një në Laç (nën administrimin e degës në Lezhë) një në Librazhd (nën administrimin e degës në Elbasan), në Bilisht dhe Pogradec (nën administrimin e degës në Korçë), Tirana 2 (nën administrimin e degës në Tiranë). Më 31 dhjetor 2021, Shoqëria ka 81 (2020:67) punonjës.

### 2. Bazat e përgatitjes

#### (a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

#### (b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

#### (c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek Shqiptar (“Lek”), e cila është edhe monedha funksionale e Shoqërisë. Informacioni financiar i prezantuar në Lek është rrumbullakosur në mijëshen më të afërt, veçse kur shprehet ndryshe.

#### (d) Vlerësimi i Drejtimit mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë

Drejtimi i shoqërisë ka vlerësuar aftësinë e saj për vijimësinë dhe është i kënaqur me faktin se shoqëria ka burimet për të vazhduar aktivitetin e biznesit të saj për të ardhmen e parashikuar. Gjithashtu, Drejtimi i shoqërisë nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të hedhë dyshime në lidhje me aftësinë e saj për të vijuar. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten duke përdorur bazën kontabël të vijimësisë.

Drejtimi ka arritur në konkluzion se nuk ka pasiguri materiale që mund të shkaktojnë dyshime në vijueshmërinë e Shoqërisë, rrjedhimisht përgatitja e pasqyrave financiare mbi këto baze është e drejte.

#### (d) Përdorimi vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime. Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen. Informacion mbi elemente të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël, që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare jepet në shënimin 3.

(Shumat në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

### 3. Politikat e rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare.

#### (a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj, përveç kapitalit, që maten me kosto historike konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj, që maten me vlerë të drejtë konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është vendosur vlera e drejtë. Fitimi apo humbja që vjen nga konvertimet njihet në fitim ose humbje nën emërtimin “Të ardhura/ (humbje) neto nga kurset e këmbimit”.

#### (b) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në humbje ose fitim bazuar në metodën e interesit efektiv. “Norma e interesit efektiv” është norma që skanton pagesat dhe arkëtimet e pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së aktivit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme gjatë një periudhe më të shkurtër kohore) të:

- vlerës kontabël bruto të aktivit financiar; ose
- koston së amortizuar të detyrimit financiar.

Gjatë llogaritjes së normës efektive të interesit, Shoqëria vlerëson flukset e ardhshme të parave duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por jo humbjet e kredisë në të ardhmen.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha komisionet dhe pikët e paguara ose të marra, kostot e transaksionit, dhe zbritjet apo primet që janë pjesë e rëndësishme përbërëse e interesit efektiv. Kostot e transaksionit janë kosto shtesë që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes, nxjerrjes ose shitjes së aktivit ose detyrimit financiar. Në llogaritjet e të ardhurave dhe shpenzimeve nga interesi, norma efektive e interesit aplikohet në vlerën kontabël bruto të aktivit (kur aktivi nuk është i zhvlerësuar) ose në koston e amortizuar të detyrimit.

Sidoqoftë, për aktivet financiare që janë zhvlerësuar pas njohjes fillestare, të ardhurat nga interesi llogariten duke aplikuar normën efektive të interesit mbi koston e amortizuar të aktivit financiar.

Në qoftë se aktivi nuk është më i zhvlerësuar, atëherë llogaritja e të ardhurave nga interesi bazohet në bazën bruto.

Për aktivet financiare që janë zhvlerësuar në njohjen fillestare, të ardhurat nga interesi llogariten duke aplikuar normën e rregulluar efektive të interesit mbi koston e amortizuar të aktivit. Llogaritja e të ardhurave nga interesi nuk kthehet në baza bruto, edhe në qoftë se rreziku i kredisë së aktivit përmirësohet.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse përfshijnë interesin në aktivet financiare dhe detyrimet financiare të matura me koston e amortizuar dhe të llogaritura në bazë të interesit efektiv.

#### (c) Tarifa dhe komisione

Shoqëria mund të fitojë të ardhura të tjera, të njohura në një vlerë që reflekton atë që Shoqëria pret të ketë në këmbim të shërbimeve që ofron dhe njihen kur detyrimi i Shoqërisë plotësohet.

#### (d) Tatim Fitimi

Shpenzimi i tatimit mbi të ardhurat përfshin tatimin e periudhes dhe tatimin e shtyrë.

##### *Tatimi i periudhes*

Shpenzimi i tatimit mbi të ardhurat njihet në fitim ose humbje, përveçse shtesës që lidhet me zërat e njohur direkt në Kapitalin Neto ose në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse. Tatimi i periudhes është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi të ardhurat e tatueshme për vitin duke përdorur normat tatimore të miratuara ose të miratuara në datën e raportimit, dhe cdo rregullim i tatimit të pagueshëm përsa i përket viteve të kaluara.

(Shumat në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

### 3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (d) Tatim Fitimi (vazhdim)

*Tatimi i shtyrë*

Tatimi i shtyrë njihet për sa i përket diferencave të përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimore që pritet të zbatohen për diferencat e përkohshme kur ato mbyllen, bazuar në ligjet që janë miratuar në mënyrë thelbësore nga data e raportimit.

Në përcaktimin e vlerës së tatimit të periudhës dhe të shtyrë, Shoqëria merr parasysh ndikimin e pozicioneve të pasigurta tatimore dhe nëse tatimet dhe interesat shtesë mund të jenë shkak për këtë.

Shoqëria beson se llogaritjet e saj për detyrimet tatimore janë të përshtatshme për të gjitha vitet e hapura të taksave bazuar në vlerësimin e saj të shumë faktorëve, përfshirë interpretimet e ligjit tatimor dhe përvojën e mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë një seri gjykimesh për ngjarjet e ardhshme. Informacioni i ri mund të bëhet i disponueshëm dhe t'i shkaktojë Shoqërisë të ndryshojë gjykimin e saj në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; ndryshime të tilla në detyrimet tatimore do të ndikojnë në shpenzimet tatimore në periudhën kur është bërë një përcaktim i tillë.

Një aktiv i tatimit i shtyrë njihet vetëm në atë masë sa është e mundur që fitimet e ardhshme të tatueshme do të jenë në dispozicion kundër të cilave aktivi mund të përdoret. Aktivet e tatimit të shtyrë rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që është e pamundur realizimi i përfitimit të taksës.

#### (e) Aktivet dhe detyrimet financiare

##### Data e njohjes

Aktivitet dhe detyrimet financiare, me përjashtim të huave dhe paradhënieve ndaj klientëve, fillimisht njihen në datën në të cilën Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin tregtime të rregullta, d.m.th., blerje ose shitje të aktiveve financiare që kërkojnë shpërndarjen e aktiveve brenda afatit kohor të vendosur përgjithësisht me rregullore. Huatë dhe paradhëniet për klientët njihen kur fondet transferohen në llogaritë e klientëve.

Shoqëria njih një aktiv financiar ose një detyrim financiar në pasqyrën e saj të pozicionit financiar kur, dhe vetëm kur, njësia ekonomike bëhet palë në provigjionet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare të Shoqërisë përfshijnë hua për klientët dhe llogaritë me bankat. Detyrimet përfshijnë hua nga bankat dhe kreditorët e tjerë, dhe të pagueshme të tjera.

Shoqëria njih të gjitha:

- Kredite për klientët fillimisht me vlerë të drejtë minus tarifat e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt emetimit të kredisë (d.m.th. tarifa e origjinës së kredisë); dhe
- Huatë nga bankat dhe kreditorët e tjerë me vlerë të drejtë plus kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt huasë së marrë (d.m.th. tarifa e huasë).

Çdo tarifë ose kosto e ndodhur në depozitat bankare afatshkurtra dhe të pagueshme të tjera pa ndonjë përbërës të rëndësishëm financiar njihen drejtpërdrejt si të ardhura ose shpenzime në llogarinë e fitimit ose humbjes kur ato ndodhin.

##### (i) Klasifikimi

Klasifikimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare në njohjen fillestare varet nga kushtet e tyre kontraktuale dhe modeli i biznesit për menaxhimin e instrumenteve, siç përshkruhet më poshtë. Aktivitet dhe detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë. Të arkëtueshme tregtare vlerësohen me çmimin e transaksionit. Kur vlera e drejtë e instrumenteve financiare në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit, Shoqëria llogarit fitimin ose humbjen e Ditës 1, siç përshkruhet më poshtë. Të gjitha aktivitet financiare klasifikohen si të matura me koston e amortizuar.

(Shumat në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

### 3. Politikat e rendesishme kontabel (vazhdim)

#### (e) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

##### (i) Klasifikimi (vazhdim)

#### Fitimi ose humbja i Dites 1

Kur çmimi i transaksionit të instrumentit ndryshon nga vlera e drejtë në origjinë dhe vlera e drejtë bazohet në një teknikë vlerësimi duke përdorur vetëm inputet e vëzhguara në transaksionet e tregut, Shoqëria njeh ndryshimin midis çmimit të transaksionit dhe vlerës së drejtë në të ardhurat neto nga tregtimi. Në ato raste kur vlera e drejtë bazohet në modele për të cilat disa nga të dhënat nuk janë të vërejtura, diferenca midis çmimit të transaksionit dhe vlerës së drejtë është shtyrë dhe njihet vetëm në fitim ose humbje kur të dhënat bëhen të vëzhguara, ose kur instrumenti është çregjistruar.

#### Vlerësimi i modelit të biznesit

Shoqëria administron pasuritë e saj financiare brenda modelit të biznesit të mbajtur për të mbledhur flukset kontraktuale të parave ('të mbajtura për të mbledhur'). Modeli i biznesit përcaktohet nga stafi drejtues në një nivel që pasqyron se si Shoqëria menaxhon kreditë e saj për klientët dhe depozitat bankare. Modeli i biznesit të Shoqërisë nuk varet nga qëllimet e stafit drejtues për një aktiv financiar individual. Shitjet nuk janë në kundërshtim me modelin e biznesit të mbajtur për t'u mbledhur nëse ato:

- ndodhin për shkak të rreziqeve të rritura të kredisë;
- janë të shpeshta, por me vlera të parëndësishme ose me vlerë të konsiderueshme, por jo të shpeshta; ose
- ndodhin shumë afër maturitetit.

Nuk ka asnjë kufizim për shitjet e bëra për shkak të një rritje të rrezikut të kredisë. Shitjet afër maturimit lejohen vetëm nëse plotësohen disa kriteret e vendosura nga Standardi.

Shoqëria mund të shesë aktive financiare individuale (d.m.th. të arkëtueshme) vetëm nëse rreziqet e kredisë të këtyre aktiveve rriten deri në atë pikë sa Shoqëria nuk do të angazhojë kohë dhe përpjekje shtesë për të mbledhur flukset e tyre kontraktuale të parave. Shitjet e huave ose pasurive të tjera financiare i nënshtrohen miratimit nga Bordi Mbikëqyrës.

Shoqëria bën një vlerësim të objektivit të një modeli biznesi në të cilin një aktiv mbahet në nivel portofoli, sepse kjo reflekton më së miri mënyrën e menaxhimit të biznesit dhe informacionit i ofrohet dhe Drejtimit. Informacioni i marrë në konsideratë përfshin:

- politikat dhe objektivat e deklaruara për portofolin dhe funksionimin e atyre politikave në praktikë. Në veçanti, nëse strategjia e menaxhimit përqendrohet në fitimin e të ardhurave nga interesi kontraktual, duke mbajtur një profil të veçantë të normës së interesit, duke përputhur kohëzgjatjen e aktiveve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë ato aktive ose realizojnë flukset e parave përmes shitjes së aktiveve;
- si vlerësohet dhe raportohet performanca e portofolit bazuar në kohën për mbledhjen e principalit dhe interesit të kontraktuar dhe minimizimin e kredive që nuk performojnë;
- rreziqet që ndikojnë në performancën e modelit të biznesit (dhe aktiveve financiare të mbajtura brenda atij model biznesi) dhe si menaxhohen ato rreziqe;
- si kompensohen menaxherët e biznesit - p.sh. nëse kompensimi bazohet në vlerën e drejtë të aktiveve të administruara ose flukset monetare kontraktuale të mbledhura; dhe frekuencën, vëllimin dhe kohën e shitjeve në periudhat e mëparshme, arsyet e shitjeve të tilla dhe pritjet e saj për aktivitetin e ardhshëm të shitjes. Sidoqoftë, informacioni mbi aktivitetin e shitjeve nuk konsiderohet i izoluar, por si pjesë e një vlerësimi të përgjithshëm se si arrihet objektivi i deklaruar i Shoqërisë për administrimin e aktiveve financiare dhe si realizohen flukset e parave.

Ndryshimet në modelin e biznesit do t'i nënshtrohen miratimit nga Këshilli Mbikëqyrës dhe do të dokumentohen përmes strategjisë së Shoqërisë për menaxhimin e aktiveve të saj, menaxhimin e rreziqeve dhe vlerësimin e performancës.

(Shumat në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

### 3. Politikat e rendesishme kontabel (vazhdim)

#### (e) Aktivitet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

##### (i) Klasifikimi (vazhdim)

#### *Vlerësimi nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit*

Për qëllimet e këtij vlerësimi, "principalit" përcaktohet si vlerë e drejtë e aktivitetit financiar në njohjen fillestare. "Interesi" përcaktohet si konsideratë për vlerën kohore të parasë dhe për rrezikun e kredisë të shoqëruar me shumën kryesore të mbetur në një periudhë të caktuar kohore dhe për rreziqet dhe kostot e tjera themelore të huazimit (p.sh. rreziku i likuiditetit dhe kostot administrative), si dhe marzhi i fitimit.

Në vlerësimin nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit, Shoqëria konsideron kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin vlerësimin nëse aktivi financiar përmban një afat kontraktues që mund të ndryshojë kohën ose shumën e fluksit monetar të kontratës në mënyrë që të mos plotësojë këtë kusht. Në bërjen e vlerësimit, Shoqëria konsideron:

- Ngjarje të mundshme që mund të ndryshojnë sasinë dhe kohën e fluksit të parave;
- Karakteristikat e levave;
- afatet e parapagimeve dhe zgjatjes;
- termat që kufizojnë pretendimin e Shoqërisë ndaj fluksit të parave nga aktive specifike (p.sh. aranzhimet e aseteve pa rekurs); dhe
- tipare që modifikojnë konsiderimin e vlerës kohore të parave - p.sh. rivendosja periodike e normave të interesit.

Shoqëria mban një portofol të huave me normë fikse afatgjatë për të cilën Shoqëria ka mundësinë të propozojë të rishikojë normën e interesit në datat periodike të rivendosura. Këto të drejta të rivendosjes janë të kufizuara në normën e tregut në kohën e rishikimit.

Huamarrësit kanë një mundësi ose të pranojnë normën e rishikuar ose të shlyejnë kredinë pa penalitet. Shoqëria ka përcaktuar që flukset monetare kontraktuale të këtyre kredive janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit sepse opsioni ndryshon normën e interesit në atë mënyrë që konsideron vlerën kohore të parave, rrezikun e kredisë, rreziqet e tjera themelore të huadhenies dhe kostot e shoqëruar me detyrimin e shumës së principalit.

#### **Kategoritë e matjes së aktiveve dhe detyrimeve financiare**

Shoqëria klasifikon të gjitha aktivitet e saj financiare bazuar në modelin e biznesit për administrimin e aktiveve dhe kushteve kontraktuale të aktivitet, të matura me:

- Koston e amortizuar

#### **Riklasifikimet**

Aktivitet financiare nuk riklasifikohen pas njohjes së tyre fillestare, përveç në periudhën pasi Shoqëria ndryshon modelin e saj të biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare.

##### (ii) Modifikime në aktivitet financiare dhe detyrimet financiare

Nëse kushtet e një aktivitet financiar janë modifikuar, Shoqëria vlerëson nëse flukset e parave të aktivitet të modifikuar do të ndryshojnë thelbësisht. Nëse flukset e parave janë në thelb të ndryshme, atëherë të drejtat kontraktuale për flukset e parave nga aktivi origjinal financiar konsiderohen të kenë skaduar. Në këtë rast, aktivi origjinal financiar çregjistrohet dhe një aktiv i ri financiar njihet me vlerën e drejtë.

Nëse flukset e parave të aktivitet të modifikuar të mbartura me kosto të amortizuar nuk janë thelbësisht të ndryshme, atëherë modifikimi nuk rezulton në çregjistrim të aktivitet financiar.

Në këtë rast, Shoqëria rillogarit vlerën kontabël bruto të aktivitet financiar dhe njeh shumën që vjen nga rregullimi i vlerës kontabël bruto si një fitim ose humbje modifikimi në fitim ose humbje. Nëse një modifikim i tillë kryhet për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit, atëherë fitimi ose humbja paraqitet së bashku me humbjet nga zhvlerësimi. Në raste të tjera, ai paraqitet si të ardhura nga interesi.

(Shumat në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

### 3. Politikat e rendesishme kontabel (vazhdim)

#### (e) Aktivitet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(iii) Mosnjohja

##### **Aktivitet financiare**

Shoqëria ka vendosur rregulla specifike për të vlerësuar nëse duhet të kryhet ç'regjistrimi i aktivitetit financiar. Në këtë kontekst duhet të vlerësohen kriteret e mëposhtme:

- ndryshimi i debitorit
- ndryshimi i monedhës
- konsolidimi i borxhit të disa kredive në një te vetme ose anasjelltas
- Nxjerrjet jashtë bilancit te pjeshme ose jo

Për mosnjohjen e një aktivi financiar, diferenca midis vlerës kontabël të aktivitetit (ose vlerës kontabël të alokuar në pjesën e aktivitetit të transferuar) dhe (i) shumës së marrë (duke përfshirë çdo aktiv të ri të marrë minus çdo detyrim të ri të marrë) dhe (ii) çdo fitim ose humbje kumulative që ka qenë i njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse njihet në fitim ose humbje.

##### **Detyrimet financiare**

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale janë refuzuar, anuluar ose skaduar.

(iv) *Politika e fshirjes së kredive*

Shoqëria mund të zvogëlojë drejtpërdrejt vlerën bruto të ekzpozimit të kredive kur nuk ka pritje të arsyeshme për rikuperimin e një aktivi financiar në tërësinë e saj ose një pjesë të tij dhe nëse ekspozimet e kredisë janë më shumë se 365 ditë vonesë.

Një fshirje përbën një ngjarje çregjistrimi. Pasi një shumë të jetë fshirë nga pasqyra e bilancit, nuk është e mundur të rikthehet / ndryshohet ai rregullim, në ndryshim me provigjionet e zhvlerësimit, të cilat mund të lirohen përmes pasqyrës së fitimit dhe humbjes kur vlerësimet në lidhje me rikuperueshmërinë e ardhshme përmirësohen. Nëse paraja ose aktive të tjera mbledhen përfundimisht, këto mbledhje njihen drejtpërdrejt si të ardhura në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

(v) *Matja e kostos së amortizuar*

'Kostoja e amortizuar' e një aktivi financiar ose detyrimi financiar është shuma në të cilën aktivi financiar ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare minus ripagimet e principalit, plus ose minus amortizimin kumulativ duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo ndryshimi midis shumës fillestare dhe shumës së maturuar dhe, për aktivet financiare, të rregulluara për çdo shtesë të pritshme të fondit të zhvlerësimit. "Vlera kontabël bruto e një aktivi financiar" është kostoja e amortizuar e një aktivi financiar përpara rregullimit me fondin e zhvlerësimit.

(vi) *Matja e vlerës së drejtë*

'Vlera e drejtë' është çmimi që do të merrej për të shitur një aktiv ose do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes në principal ose, në mungesë të tij në tregun më të favorshëm ku Shoqëria ka akses në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyron rrezikun e tij të mos performimit.

Kur është e mundur, Shoqëria mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg vlerësohet si aktiv nëse transaksionet për aktivin ose detyrimin zhvillohen me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacion mbi çmimet në bazë të vazhdueshme.

Nëse nuk ka një çmim të kuotuar në një treg aktiv, atëherë Shoqëria përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e inputeve përkatëse të vëzhguara dhe minimizojnë përdorimin e inputeve të pa vëzhguara. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh në çmimin e një transaksioni.

(Shumat në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

### 3. Politikat e rendesishme kontabel (vazhdim)

#### (e) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

##### (vii) Matja e vlerës së drejtë (vazhdim)

